Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 05-03-2019
Nr.i org. / Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë / Prilog | Vlera / Vrednost
02-035/02-224

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipallity of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të "Caritas Kosova" dhe Komunës së Vitisë nr 02-035/02-672 të datës 09.07.2018, për projektin: Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmuar dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

# VENDIM

**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 8.800,00 € NË EMËR TË BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmuar dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018"**

I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë ndan mjete financiare në shumë prej **8.800,00 €** ( tetëmijetetëqind euro) në emër të bashkëfinancimit për realizimin e projektit "Përkujdesi shtëpiak dhe asistenca për të moshuarit e sëmuar dhe të vetmuar në Viti, Home Care II 2018" , bazuar në Marrëveshjen për bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes të "Caritas Kosova", dhe Komunës së Vitisë numër 02-035/02/672 të datës 09.07.2018.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2019 nga kodi për mallra dhe shërbime – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –për pagesën e Faturës 29-1/2018 të datës 04.03.2019.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të "Caritas Kosova".

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti, më 05.03.2019

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti